



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 20 tetor 2020

Lënda nr. 2020-01

Reihan Kaja

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") i mbledhur më 20 tetor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Kjo ankesa është regjistruar më 17 shtator 2020.

II. FAKTET

2. Ankuesi është ish staf i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë (këtu e tutje "Misioni"). Sipas informacionit të paraqitur nga ankuesi, ai ishte larguar nga Misioni si rezultat i një procesi të reduktimit të stafit në ish-njësinë e tij diku në vitin 2018.
3. Në gusht të vitit 2020, ai kishte aplikuar për një pozitë pune në Mision, por nuk ishte përzgjedhur.

III. ANKESAT

4. Ankuesi pretendon se të drejtat e tij të njeriut janë shkelur sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950). Ankuesi nuk përmend ndonjë dispozitë të veçantë të këtyre instrumenteve. Sidoqoftë, ai pretendon se Misioni, në vendimin për kuadro dhe rekrutimin e tij, ka abuzuar me autoritetin e tij, i ka mohuar ankuesit të drejtën për të praktikuar lirisht fenë e tij dhe ka diskriminuar ankuesin në bazë të fesë dhe nacionalitetit të tij. Ankuesi gjithashtu pretendon se Misioni është penalisht përgjegjës për abuzimin e pozitës zyrtare dhe ushtrimin e ndikimit mbi të tjerët.

IV. LIGJI

5. Përpara shqyrtimit të ankesës për bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh Rregullin 29(1) të rregullores së tij të punës. Kjo dispozitë thekson se Paneli mund të shpall një ankesë të papranueshme në procedurat e shkurtuara, *ndër të tjera*, nëse ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit.
6. Sipas Rregullës 25(1) të Rregullores së Procedurës, juridiksioni i Panelit është i kufizuar në shqyrtimin e ankesave për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i Misionit ishte deri në qershor të vitit 2018 i kufizuar në çështje të caktuara në sektorët e policisë, drejtësisë dhe doganave dhe ky mandat ekzekutiv edhe më tej ishte kufizuar në qershor të vitit 2018 (shih Aksionin e Përbashkët 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 mbi Rregulloren e Bashkimit Evropian i Misionit të Drejtësisë në Kosovë, EULEX-i KOSOVË dhe Vendimit të Këshillit (CFSP) 2018/856 të datës 8 qershor 2018 për ndryshimin e Aksionit të Përbashkët 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË).
7. Kjo ankesë ka të bëjë me vendimin në lidhje me vendimin për kuadro dhe rekrutim në punë, të cilat bien jashtë mandatit ekzekutiv të Misionit. Si pasojë, ato gjithashtu bien jashtë fushës së llojeve të veprimeve që Paneli mund t'i shqyrtojë (shih, p.sh., *Hunaida Pasuli kundër EULEX-it*, 2010-12, 14 shtator 2010, paragrafi 7; *Bojan Mirković kundër EULEX-it*, 2011-09, 8 qershor 2011, par 15).
8. Paneli gjithashtu vëren se ankuesi është një ish pjesë e stafit të Misionit. Paneli i referohet Rregullës 25(1) të Rregullores së vet të punës, e cila parashikon që një ankesë mund të paraqitet nga çdo person tjetër përveç personelit të EULEX-it Kosovë. Prandaj, Paneli nuk është kompetent për t'u marrë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të kryera ndaj personelit të EULEX-it (shih, p.sh., *Liridona Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it*, 2014-41, 15 qershor 2015, par 16; *Nuha Beka kundër EULEX-it*, 2014-25, 10 nëntor 2014, par. 6; *Një punonjës i EULEX-it kundër EULEX-it*, 2010-13, 14 shtator 2010, par. 5). Paneli vëren, si një observim i përgjithshëm, se mandati i tij u krijua për t'i ofruar asaj një juridiksion që është i kufizuar *ndër të tjera* nga Rregulla e lartpërmendur 25(1) në lidhje me stafin e Misionit, në kuptimin që mjetet e tjera mund të jenë në dispozicion për çështje që bien jashtë këtij juridiksioni. Në dritën e fakteve dhe rrethanave të çështjes në fjalë, Paneli nuk ka nevojë të vendosë nëse mjetet e tjera janë në dispozicion të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë fushës së juridiksionit të tij, në kuptim të Rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të Rregullores së tij të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare



Anna AUTIO
Anëtare